



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 74, datë 28.04.2023**

**MBI**  
**PËRFUNDIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË SË BROKERIMIT**  
**“SUNTRUST BROKER” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikat 4, 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 211, pika 6, germa c), të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E :**

Referuar analizës së pasqyrave financiare të vitit 2022, ka rezultuar se vlera e kapitalit të shoqërisë “SunTrust Broker” sh.a., në fund të vitit 2022, është në vlerën 2,118,989 lekë, në kundërshtim me nenin 211, pika 1, germa a), të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”. Lidhur me këtë problematikë, Autoriteti ka kërkuar nga shoqëria shtimin e menjëhershëm të kapitalit, në përputhje me kërkesat ligjore, duke e paralajmëruar shoqërinë se mospërbushja e kushteve për të cilat është dhënë licenca dhe shkelja e dispozitave ligjore përbën shkak për revokim licence, sipas nenit 211, pika 4, gjerat ç) dhe e), të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Shoqëria “SunTrust Broker” sh.a., ka informuar Autoritetin se shoqëria nuk mundet që të plotësojë kërkesën për shtimin e menjëhershëm të kapitalit dhe për këtë arsye është në fazën e përgatitjes së shoqërisë për likuidim. Me anë të shkresës më datë 04.04.2023, protokolluar në Autoritet me nr. prot. 1058, datë 06.04.2023 shoqëria “SunTrust Broker” sh.a., ka depozituar Vendimin e Asamblesë së aksionerëve të shoqërisë “Për emërimin e likuidatorit të shoqërisë “SunTrust Broker” sh.a., në procesin e likuidimit të zakonshëm”, duke vendosur: prishjen e shoqërisë “SunTrust Broker” sh.a., me pasojë hapjen e procedurave të likuidimit të zakonshëm.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

## **V E N D O S I :**

- 1. Përfundimin e Licencës nr. 24, datë 31.01.2018 të shoqërisë “SunTrust Broker” sh.a., “Për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime për klasat e jetës, jojetës dhe risigurime”.**
- 2. Çregjistrimin nga regjistri i të licencuarve pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.**
- 3. Ngarkohen departamentet përkatëse, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**

**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin METE**